



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 81 dt. 09.10.2014

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 09.10.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të projekt- idesë “Rehabilitimi i fasadave përgjatë Bulevardit Republika-Berat” me vërejtjet:
 - Të respektohet origjinaliteti i fasadave të objekteve për të gjitha ndërhyrjet e parashikuara në projekt.
 - Objekti 7: Të mos ketë ndryshime në fasadën ballore të objektit dhe të parashikohet restaurimi i fasadave anësore.
 - Objekti 8: Të restaurohet duke respektuar gjurmët origjinale, volumin dhe elementët arkitektonikë. Të hapen të gjitha hapësirat e dritës që janë të mbyllura sipas gjurmëve ekzistuese.
2. Pas reflektimit të vërejtjeve projekti i zbatimit të shqyrtohet nga DRKK Berat, KSH në IMK dhe KKR.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

